

Udhëzues praktik: Akses në procedurën e azilit





This Project is funded by the European Union

Ky dokument u botua falë asistencës së Bashkimit Evropian nëpërmjet projektit “Mbështetje rajonale për menaxhimin e migracionit me fokus te mbrojtja në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi - Faza II”. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e EASO-s dhe nuk pasqyron domosdoshmëri pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

**Europe Direct is a service to help you find answers
to your questions about the European Union.**

Freephone number (*):

00 800 6 7 8 9 10 11

(*) The information given is free, as are most calls (though some operators,
phone boxes or hotels may charge you).

More information on the European Union is available on the internet (<http://europa.eu>).

Designed by EWORX

Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2020

Practical Guide:

SQ	BZ-04-15-715-SQ-N	ISBN 978-92-9485-448-3	doi:10.2847/652592
----	-------------------	------------------------	--------------------

© European Union, 2020

Reproduction is authorised provided the source is acknowledged.

Printed by Bietlot in Belgium

PRINTED ON ELEMENTAL CHLORINE-FREE BLEACHED PAPER (ECF)

Udhëzues praktik: Akses në procedurën e azilit

Hyrje

Duke qenë se jeni shpesh pika e parë e kontaktit për shtetasit e vendeve të treta që mbërrijnë në vendin tuaj, dhe në shumë raste në të gjitha vendet e BE-së, ju luani një rol vendimtar në lehtësimin e qasjes efektive në mbrojtjen ndërkombëtare. Kjo mund të arrihet duke identifikuar në mënyrë proaktive personat që mund të kenë nevojë për mbrojtje, duke u ofruar informacionet përkatëse mbi të drejtën për të aplikuar për azil, duke i referuar drejt procedurave të përshtatshme dhe ndihmave të tjera si dhe drejt garancive procedurale që u ofrohen këtyre personave.

Udhëzuesi ofron informacione mbi detyrimet kryesore të punonjësve të kontaktit të parë dhe mbi të drejtat e personave të cilët mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në momentin e kontaktit të parë. Ai do të jetë busulla juaj përgjatë procesit të identifikimit të personave që mund të kenë dëshirë të aplikojnë për mbrojtje dhe përgjatë ofrimit të garancive përkatëse procedurale si dhe shërbimeve mbështetëse.

Udhëzuesi ndahet në katër pjesët e mëposhtme:

- **Rritja e rolit të punonjësve të kontaktit të parë në aksesin në procedurën e azilit:** e cila përfshin një hyrje në kontekstin e flukseve të migrimit të përzier dhe një pasqyrë të sfondit përkatës ligjor, duke përfshirë të të drejtave themelore;
- **Si të jeni të përgatitur për të dalluar një aplikant të mundshëm për mbrojtje ndërkombëtare:** këtu parashtrohen kushtet e nevojshme paraprake lidhur me sjelljen dhe mentalitetin e punonjësve të kontaktit të parë në mënyrë që të jenë në gjendje të identifikojnë personat që mund të dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare;
- **Të dhënat që një person mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare:** këtu jepen udhëzime se cilat elemente duhet të merren parasysh për të bërë një identifikim më të mirë të personit që dëshiron të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare.
- **Hapat e mëtejshëm:** e cila ofron udhëzimeve për situatat kur identifikohet një person që mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe veprimet që duhen kryer nëse është bërë një aplikim. Kjo pjesë trajton gjithashtu situatat kur një person që mund të ketë nevojë për mbrojtje nuk dëshiron të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Kini parasysh se legjislacioni i BE-së për azilin përcakton se punonjësit që kanë kontaktin e parë me personat që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, në veçanti punonjësit që kryejnë kontrollin e kufijve tokësorë ose detarë ose që kryejnë kontrollet kufitare, duhet të marrin informacionin përkatës dhe trajnimin e nevojshëm mbi mënyrat e njohjes dhe trajtimit të aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare.

Pasqyra e lëndës

Hyrje	v
Rritja e rolit të punonjësve të kontaktit të parë në momentin e aksesit në procedurën për azil	1
Roli kryesor i punonjësve të kontaktit të parë	1
Të drejtat themelore	2
Parimi i moskthimit	3
Aksesi në procedurën e azilit	3
Si të jeni të përgatitur për të njohur një aplikant të mundshëm për mbrojtje ndërkombëtare	6
Jini proaktiv	6
A jeni proaktivë apo reaktivë?	6
Vëzhgoni	7
Kushtojini vëmendje dobësive	7
Fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë	8
Jini mendjehapur	8
Jini i respektueshëm	8
Mos diskriminoni	9
Mos jini paragjykses	9
Jini dëgjues aktiv	9
Përdorni një stil komunikimi të përshtatshëm dhe të ndjeshëm	10
Puna me përkthyesin	10
Kushtojini vëmendje gjuhës tuaj të trupit	11
Jini të vetëdijshëm për rrethanat tuaja personale	11

Treguesit që dikush mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare	12
Kush mund të dëshirojë të bëjë aplikim?	12
Personat me nevoja të shumëfishta për mbrojtje	13
Lista joshteruese e treguesve	13
Kush është personi dhe prej nga vjen	14
Çfarë thotë personi	15
Çfarë mund të vëzhgoni (pamja e jashtme dhe sjellja)	15
Hapat e mëtejshëm	17
Jepni informacionin	17
Njihni paraqitjen e një aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare	17
Hapat e mëtejshëm nëse një person aplikon për mbrojtje ndërkombëtare	18
Hapat e mëtejshëm nëse një person që mund të ketë nevoja për mbrojtje nuk dëshiron të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare	19
Akses në procedurën e azilit	21
Shtojca — Referencat ligjore	23

Rritja e rolit të punonjësve të kontaktit të parë në momentin e aksesit në procedurën për azil


Roli kryesor i punonjësve të kontaktit të parë

Zgjerimi i objektit dhe ndërlimit të lëvizjeve migratore krijon një mjedis sfidues në kufijtë e jashtëm të BE-së. Personat me motive dhe objektiva të ndryshme lëvizin së bashku me njëri-tjetrin brenda flukseve mikse migratore duke përdorur të njëjtat rrugë dhe mjete transporti. Udhëtime të tilla mund të jenë të gjata, të vështira dhe kërcënuese për jetën, shpesh të organizuara në mënyrë të parregullt. Të fshehur në kamionë, kontejnerë të vegjël ose të rrasur në anije të pasigurta, njerëzit shpesh udhëtojnë në kushte të ashpra dhe të pasigurta, të ekspozuar ndaj rrezikut, urisë, shfrytëzimit e abuzimit nga kontrabandistët dhe trafikantët. Gjatë udhëtimit ata mund të humbasin anëtarët e familjes ose të afërmit. Ka raporte të panumërta për persona që shfrytëzohen, keqtrajtohen, përdhunohen dhe detyrohen të ushtrojnë prostitucion apo kryejnë vepra penale.



Duke qenë shpesh pika e parë e kontaktit për shtetasit e vendeve të treta që arrijnë në vendin tuaj, dhe në shumë raste në tërë vendeve të BE-së, ju keni një rol vendimtar në identifikimin në kohë të këtyre personave, duke trajtuar nevojat e tyre themelore, duke iu garantuar të drejtat e tyre bazë, duke iu dhënë informacion dhe duke i orientuar drejt procedurave të përshtatshme dhe autoriteteve kompetente.

Krahas njerëzve që udhëtojnë për arsye që nuk kanë të bëjnë me mbrojtjen, janë edhe ata me nevoja për mbrojtje, për të cilat nevojitet marrja e masave të menjëhershme. Këtu mund të përfshihen personat që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, torturës, përdhunimit ose formave të tjera të rënda të dhunës, fëmijët e ndarë ose të pashoqëruar, gratë në rrezik dhe persona të tjerë të cënueshëm.




Të drejtat themelore

Çdo masë e marrë në pikat e kalimit kufitar dhe në institucionet penitenciare duhet të jetë në proporcion me objektivat e synuara, të jetë jodiskriminuese dhe të respektojë plotësisht të drejtat themelore kryesore, si:

- Dinjiteti njerëzor që përcakton se një qenie njerëzore ka të drejtën e lindur që të vlerësohet, respektohet dhe trajtohet me dinjitet.
- E drejta për të jetuar që ndalon dënimin me vdekje ose ekzekutimin dhe përcakton detyrën për të marrë masa parandaluese në situata ku ekziston një rrezik real dhe i menjëhershëm për jetën e një individi.
- Ndalimi i torturës që përcakton se askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor ose poshtërues.
- Parimi i moskthimit që i referohet detyrimit të shteteve anëtare për të mos dëbuar ose kthyer një person në çfarëdo mënyre në një situatë ku mund të ndeshet me persekutim dhe/ose torturë, trajtim apo dënim çnjerëzor ose poshtërues.
- E drejta për azil që i jep të gjithëve të drejtën për të kërkuar dhe për të gëzuar në vende të tjera mbrojtje nga persekutimi. Shtetet anëtare duhet të sigurohen që çdo person, qoftë i rritur apo fëmijë, të ketë të drejtë të bëjë aplikim për mbrojtje ndërkombëtare në emër të tij apo të saj ose në emër të të afërmit ose përfaqësuesit të tij/të saj.
- Mosdiskriminimi që ndalon çdo trajtim të padrejtë ose veprim apo dallim arbitrar mbi çfarëdolloj baze si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose sociale, karakteristikat gjenetike, gjuha, feja apo besimi, opinioni politik apo ndonjë opinion tjetër, anëtarësia në një minoritet kombëtar, prona, prejardhja, aftësia e kufizuar, mosha ose orientimi seksual.

Çdo person i gëzon këto të drejta pavarësisht nëse ai/ajo ka aplikuar shprehimisht për mbrojtje ndërkombëtare apo jo.



Shtetet anëtare duhet të sigurohen që autoritetet të respektojnë parimin e konfidencialitetit, siç përkufizohet në legjislacionin e brendshëm dhe vendoset nga legjislacioni i BE-së, në lidhje me çdo informacion që marrin gjatë punës së tyre. Informacioni në lidhje me faktin që një person ka aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare nuk mund të zbulohet tek autoritetet e vendit të origjinës së personit.

Parimi i moskthimit

Parimi i moskthimit i referohet detyrimit të shteteve anëtare për të mos dëbuar ose kthyer ndonjë individ në çfarëdo mënyre në kufijtë e territoreve ose në ndonjë vend ku mund të ndeshen me persekutim, si dhe trajtim apo ndëshkim çnjerëzor ose poshtërues, duke përfshirë torturën, edhe nëse ky individ është në situatë të parregullt migratore. Në kontekstin e azilit, parimi i *moskthimit* përfshin një kërkesë për t'u dhënë individëve që kërkojnë akses në mbrojtjen ndërkombëtare në territor dhe në procedura të drejta dhe efikase të azilit për të përcaktuar nëse personit i duhet dhënë mbrojtje apo jo.

Kujt i drejtohet? Detyrimi i *moskthimit* është detyrues për të gjitha organet e një shteti, si dhe çdo person apo subjekt tjetër që vepron në emër të tij, përfshirë edhe punonjësit e kontaktit të parë.

Çfarë përfshin? Ndalimi i *kthimit* ndaj rrezikut të persekutimit sipas të drejtës ndërkombëtare të refugjatëve është i zbatueshëm për çdo formë të largimit me forcë, duke përfshirë deportimin, dëbimin, ekstradimin, transferimin joformal ose "dorëzimet" dhe mospranimin në kufi. Kjo përfshin edhe *kthimin* indirekt, që është *kthimi* i një personi në një vend të tretë ku ekziston rreziku i *kthimit*. Një vlerësim i besueshëm për rrezikun e *kthimit* indirekt duhet të ndërmerret në çdo rast individual, përpara transferimit në një vend të tretë. Asnjë azilkërkuar nuk duhet të kthehet në një vend të tretë për përcaktimin e kërkesës pa garanci të mjaftueshme në çdo rast individual. Këto garanci përfshijnë faktin që personi do të ripranohet në atë vend, do të gëzojë mbrojtje efektive kundër *kthimit*, do të ketë mundësinë të kërkojë dhe të gëzojë azil dhe do të trajtohet në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare.

Akresi në procedurën e azilit

Për të siguruar respektimin e parimit **Sigurimi i parimit të moskthimit** të moskthimit **E drejta për azil** dhe në mënyrë që e drejta për azil të jetë e efektshme, çdo personi që mund të ketë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare duhet t'i sigurohet akses në procedurën e azilit.



Mos harroni se në shumicën e skenarëve njerëzit do të kenë mundësinë t'ju shprehin juve për herë të parë nevojën e tyre për mbrojtje dhe nevojat e tyre të veçanta.

Shumë persona që mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare nuk i njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe nuk kërkojnë në mënyrë aktive azil në vendin ku mbërrijnë. Si pikë e parë e kontaktit për personat e pranishëm në kufi, ju keni një rol thelbësor në lehtësimin e aksesit në mbrojtjen ndërkombëtare duke identifikuar në mënyrë proaktive personat që mund të dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare,

duke u ofruar informacionet përkatëse mbi të drejtën për të aplikuar për azil dhe duke i udhëzuar drejt procedurave të duhura.

Masat e marra në pikat e kalimit kufitar dhe në institucionet penitenciare shënojnë një nga momentet fillestare ku mund të deklarohen ose zbulohen nevojat e veçanta të personave të cënueshëm. Si punonjës i kontaktit të parë, ju gjithashtu keni përgjegjësinë për të identifikuar nevojat e veçanta të personave të cënueshëm dhe t'i drejtoni për vlerësim të mëtejshëm dhe/ose për mbështetje tek autoritetet kombëtare.

Për të identifikuar më mirë nevojat e veçanta të personave të cënueshëm, ju mund të përdorni mjetin praktik të EASO-s për identifikimin e personave me nevoja të veçanta (IPSN), i cili disponohet në: <https://ipsn.easo.europa.eu>

Roli juaj në sigurimin e aksesit në procedurën e azilit, të parashikuar në nenin 3, germa "a", të Kodit për Kufijtë e Shengenit ⁽¹⁾, është përmirësuar më tej nga legjislacioni i BE-së *për azilin*, veçanërisht nga Direktiva e rishikuar për procedurat e azilit (DPA), e zbatueshme që nga 20 korriku 2015 ⁽²⁾. DPA-ja e rishikuar paraqet, ndër të tjera, dy dispozita kyçe që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në punën tuaj të përditshme:



Neni 8 Rishikimi i DPA-së kërkon që të jepni informacion rreth mundësisë për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare kur ka tregues se një person i mbajtur në institucionet penitenciare ose i pranishëm në pikat e kalimit të kufijve të jashtëm mund të dëshirojë ta bëjë këtë. Në praktikë kjo do të thotë që ju duhet të jeni proaktiv në identifikimin e një personi të tillë, ta informoni për të drejtën për të aplikuar për azil dhe ta këshilloni se si të bëjë aplikimin.



Neni 6 Rishikimi i DPA-së kërkon që ju ta drejtoni një person që ka shprehur qëllimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare (d.m.th. që ka bërë aplikim për mbrojtje ndërkombëtare) në procedurën e azilit duke e informuar për vendin dhe mënyrën e dorëzimit të aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare.

Rishikimi i DPA-së gjithashtu përshkruan tre hapa të veçantë të aksesit në procedurë, duke bërë dalimin e qartë midis paraqitjes, regjistrimit dhe dorëzimit të një aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare dhe pozicionit të këtij personi në lidhje me procedurën e azilit.



Kini parasysh se njerëzit mund ta shprehin synimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në mënyra të ndryshme. Çdo shprehje e frikës së persekutimit ose cenimit serioz nëse u refuzohet hyrja, e shprehur gojarisht ose me shkrim, konsiderohet si kërkesë e tillë. Nuk është e nevojshme të përdoret vetëm fjala "azil" apo "refugjat". Nëse keni dyshime, duhet të supozoni se është bërë një kërkesë për mbrojtje.

Paraqitja e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare nënkupton veprimin e shprehjes, në çfarëdo mënyre dhe pranë çfarëdo autoriteti, së dëshirës së një personi për të marrë mbrojtje ndërkombëtare. Kushdo që ka shprehur qëllimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare konsiderohet të jetë aplikant me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë këtij statusi.

Pasi të jetë paraqitur aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare, ai duhet të regjistrohet nga autoritetet kompetente brenda afatit të caktuar – jo më vonë se tri ditë pune nëse aplikimi është paraqitur për regjistrim pranë një autoriteti përgjegjës ose jo më vonë se gjashtë ditë pune nëse aplikimi është paraqitur pranë autoriteteve

të tjera, siç janë policia, rojet kufitare, autoritetet e imigracionit dhe/ose personeli i institucioneve penitenciare. Në rrethana të jashtëzakonshme, kur numri i madh i aplikimeve të njëkohshme e bëjnë shumë të vështirë në praktikë respektimin e afateve kohore të dhëna, afati mund të zgjatet deri në 10 ditë pune.

⁽¹⁾ Rregullorja (KE) nr. 562/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 marsit 2006 për krijimin e një Kodi të Komunitetit për rregullat që drejtojnë lëvizjen e personave përmes kufijve (Kodi për Kufijtë e Shengenit)

⁽²⁾ Direktiva 2013/32/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2013 për procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare (e rishikuar), më tutje referuar si DPA-ja e rishikuar.

Për aplikantin, dorëzimi i aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare nënkupton ofrimin e informacioneve/dokumenteve për të plotësuar dosjen e krijuar në kohën e regjistrimit të aplikimit. Dorëzimi i aplikimit nxit fillimin e ekzaminimit të parë. Shtetet anëtare mund të vendosin rregulla për mënyrën dhe vendin e kryerjes së dorëzimit.




Kini parasysh se detyra juaj është të identifikoni personat që mund të dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare, t'u jepni informacione dhe t'i drejtoni tek autoriteti përkatës. Ju nuk mund t'i mohoni askujt aksesin në procedurën e azilit. Drejtimi i menjëhershëm dhe efikas tek autoritetet kompetente është çelësi për t'u siguruar që e drejta për azil të garantohet në praktikë. Nuk është përgjegjësia juaj të vlerësoni nëse personi përpara jush ka nevoja për mbrojtje dhe nëse mund t'i jepet ose jo mbrojtje ndërkombëtare.

Si të jeni të përgatitur për të njohur një aplikant të mundshëm për mbrojtje ndërkombëtare

Personat në nevojë për mbrojtje kanë të ngjarë që t'i qasen një personi në uniformë dhe të krijojnë kontakt me të. Megjithatë, shumë prej tyre mund të jenë keqtrajtuar nga punonjës zyrtarë në vendin e tyre të origjinës ose në vende të tjera gjatë udhëtimit. Prandaj, në shumë raste, ata nuk do t'ju qasen drejtpërdrejt dhe është roli juaj të krijoni një atmosferë besimi, t'i identifikoni në mënyrë proaktive si persona që mund të dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare dhe t'i drejtoni ata që kuptohet se kërkojnë mbrojtje.

Ky seksion jep udhëzime se si të jeni të përgatitur për të përmbushur detyrimet tuaja për të identifikuar personat që mund të kenë nevojë për mbrojtje, për t'i pranuar në territorin e BE-së, për t'u ofruar informacione dhe për t'i drejtuar në procedurën kombëtare të azilit.



Jini proaktiv

Të qenit proaktiv do të thotë t'i fokusoni përpjekjet tuaja në elementet që mund t'i kontrolloni ose tek të cilat mund të kenë ndikim. Një qasje proaktive do t'ju ndihmojë t'i përmbushni detyrat tuaja.

Rojet kufitare dhe punonjësit e kontaktit të parë kanë përgjegjësi të jenë proaktivë në sigurimin e një aksesit efikas në procedurën e azilit. Ata kanë për detyrë të identifikojnë personat që mund të dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare, t'i informojnë për të drejtën për të aplikuar për azil dhe t'u japin informacion mbi mënyrën e aplikimit. Ata gjithashtu duhet t'i informojnë personat që kanë bërë aplikim për mbrojtje ndërkombëtare mbi mënyrën e dorëzimit të këtij të fundit.

A jeni proaktivë apo reaktivë?

Një person proaktiv përdor gjuhë proaktive (mundem, do të, preferoj etj.) dhe i fokuson përpjekjet te fusha e vet të ndikimit dhe te gjërat që mund t'i kontrollojë dhe tek të cilat mund të ketë ndikim.

Një person reaktiv përdor gjuhë reaktive (nuk mundem, duhet të, po sikur etj.) dhe i fokuson përpjekjet e veta te fusha e interesit, te gjërat mbi të cilat ka pak ose aspak kontroll.

Vëzhgimi

Vëzhgimi nuk është njëloj si thjesht "t'u hedhësh një sy gjërave". Ai është një marrje aktive e informacionit që ju ndihmon t'i vlerësoni njerëzit dhe rrethanat më shpejt dhe më saktë. Ai kërkon që t'i mbani sytë dhe veshët hapur për të marrë sa më shumë informacion të jetë e mundur dhe për ta mbajtur mend.

- **Kushtojini vëmendje të veçantë gjithçkaje rreth jush.** Përpiquni të vëreni, sa më shumë që mundeni, nga gjërat rutinë tek ato të pazakonta dhe përpiquni t'i mbani mend. Fokusohuni te ndryshimet, dallimet dhe situatat e rrethanat e pazakonta. Ndërgjegjshmëria për përshtypjet tuaja është një pjesë kyçe e të qenit një vëzhgues i mirë.
- **Kërkoni tregues që tregojnë** se një person mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare.
- **Kushtojini vëmendje të veçantë gjuhës** së trupit të personave që vëzhgoni - shprehjet e fytyrës, gjestet, kontakti me sy, pozicionet dhe toni i zërit. Aftësia për ta kuptuar dhe përdorur gjuhën e trupit mund t'ju ndihmojë për t'u lidhur me njerëzit e tjerë dhe për të identifikuar nevojat e tyre. Megjithatë, kini parasysh se kuptimi i gjuhës së trupit dhe sinjaleve joverbale mund të ndryshojnë nga vendi dhe kultura. Prandaj është e rëndësishme t'i shmangni keqinterpretimet dhe të mos bëni interpretim të nxituar.

Kushtojini vëmendje dobësive

Kini parasysh se personi përpara jush mund të jetë i cenueshëm dhe të ketë nevoja të veçanta që kërkojnë vëmendje të veçantë dhe veprim të menjëhershëm. Është detyra juaj t'i identifikoni nevojat e veçanta të personave të cenueshëm dhe t'i drejtoni për mbështetje dhe/ose vlerësim të mëtejshëm.

Pikat e kalimit kufitar dhe institucionet penitenciare janë një nga vendet kryesore ku mund të deklarohen ose zbulohen nevojat e veçanta të personave të cenueshëm. Megjithatë, kini parasysh se ato mund të mos vërehen menjëherë dhe mund të shfaqen vetëm në fazat e mëvonshme.

Sigurohuni që çdo masë e marrë në pikat e kalimit kufitar ose në institucionet penitenciare nuk ndikon në mbrojtjen specifike të ofruar sipas të drejtës ndërkombëtare për personat në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe për personat e cenueshëm, si gratë dhe vajzat në rrezik, duke përfshirë gratë shtatzëna; fëmijët, përfshirë fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë; viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore; personat që i janë nënshtruar torturës, përdhunimit ose formave të tjera të rënda të dhunës; dhe personat me aftësi të kufizuara.

- Regjistroni cenueshmërinë dhe nevojat e veçanta sa më shpejt që të jetë e mundur në përputhje me praktikën kombëtare dhe komunikojani këtë informacion palëve përkatëse të interesit në mënyrë që të ofrohen garancitë dhe mbështetja e nevojshme.
- Sigurohuni që jeni të vetëdijshëm për mekanizmat dhe procedurat tuaja kombëtare të referimit dhe të keni në dispozicion informacionin e kontaktit të institucioneve përgjegjëse në përputhje me praktikën kombëtare, duke përfshirë shërbimet e specializuara për mbrojtjen e fëmijëve, UN-HCR-në dhe organizata të tjera që ofrojnë këshillim ligjor ose këshillime të tjera për aplikantët.
- Përshtateni qasjen, gjuhën dhe stilin tuaj të komunikimit sipas nevojave të personit. Aftësia juaj për të krijuar besimin dhe për të komunikuar me personin është thelbësore, si për të mundur të identifikoni shenjat e mundshme të cenueshmërisë ashtu edhe për të mbledhur të dhëna të sakta.
- Nëse është e nevojshme, siguroni ndihmën e nevojshme mjekësore dhe/ose ndihmë tjetër të përshtatshme sipas legjislacionit dhe praktikës kombëtare.

Fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë

Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe standardet përkatëse ligjore ndërkombëtare dhe evropiane, fëmijë është çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, përveç nëse, sipas ligjit në fuqi për fëmijën, mosha madhore arrihet më herët. Edhe nëse nuk jeni i sigurt nëse personi që pretendon të jetë fëmijë është apo jo i tillë, ai/ajo duhet të drejtohet tek autoriteti përgjegjës për vlerësimin e moshës sipas legjislacionit të brendshëm dhe praktikës kombëtare dhe në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Fëmijët janë në thelb të cenueshëm dhe është shumë e rëndësishme që të jeni veçanërisht të ndjeshëm ndaj nevojave të tyre të veçanta, sidomos në rastin kur ata janë të pashoqëruar ose të ndarë. Fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë duhet të identifikohen dhe të drejtohen tek autoritetet përgjegjëse sa më shpejt që të jetë e mundur, sipas legjislacionit dhe praktikës kombëtare. Në përputhje me legjislacionin e BE-së, në rastin e fëmijëve të pashoqëruar duhet të sigurohen garancitë specifike, në veçanti caktimi sa më shpejt i një përfaqësuesi. Sigurohuni që jeni në dijeni të procedurave kombëtare të referimit dhe që keni në dispozicion të dhënat e kontaktit të shërbimeve të specializuara për mbrojtjen e fëmijëve dhe palëve të tjera përgjegjëse të interesit në dispozicion.

Qëndroni gjithmonë vigjilent dhe kushtojini vëmendje treguesve të mundshëm të trafikimit. A ka ndonjë gjë të pazakontë në situatën që shihni? A është fëmija i heshtur, i tërhequr / i largët, i pakuptueshëm, i frikësuar, i mërzhitur? A ka një person në pritje të fëmijës apo fëmija po kërkon një të rritur tjetër? Në çdo kohë, në qoftë se ekziston dyshimi i arsyeshëm se fëmija mund të jetë në rrezik trafikimi ose nëse ka nevojë për mbrojtje, mekanizmi i referimit dhe hetimi fillestar zbatohen menjëherë sipas legjislacionit dhe praktikës kombëtare.

Mos harroni të komunikoni në mënyrë miqësore për fëmijët, duke marrë parasysh moshën dhe pjekurinë e fëmijës. Mbajeni të informuar për çfarë po ndodh dhe çfarë do të ndodhë. Sigurojini akses të shërbimeve bazë.

Përparësi gëzon interesi më i lartë i fëmijës gjatë të gjitha veprimeve dhe vendimeve kur bëhet fjalë për ta. Si rregull i përgjithshëm, fëmijët nuk duhet të ndahen nga prindërit ose të afërmit e tyre shoqëruar, përveç nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se nuk është në interesin e tyre më të lartë që të qëndrojnë me ta. Në këtë rast, shërbimet e specializuara për mbrojtjen e fëmijëve duhet të informohen menjëherë sipas legjislacionit dhe praktikës kombëtare.

Parimi i *moskthimit* duhet të zbatohet. Nëse zbatohet kthimi, duhet të respektohen masat mbrojtëse për fëmijët, të parashikuara në nenin 10 të Direktivës për kthimin.

Jini mendjehapur

Kategorizimi i njerëzve që sapo keni takuar dhe përdorimi i metodave të zakonshme për të kryer de-tyrat e përsëritura është një reagim normal dhe procesi që përdor shumica prej nesh. Megjithatë, është e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm për këtë dhe të jeni gjithmonë mendjehapur, pavarësisht nga përvoja jonë e mëparshme personale dhe profesionale. Kini parasysh se çdokush mund të ketë nevojë për mbrojtje, pavarësisht paraqitjes apo mënyrës së veprimit.

Jini mendjehapur. Të jesh mendjehapur do të thotë të jesh fleksibël dhe t'u përshtatesh përvojave, procedurave dhe sfidave të reja e të ndryshme. Personat mendjehapur kanë më pak paragjykime dhe më shumë gjasa të ndryshojnë mendimet e tyre kur u paraqiten fakte të reja.

Jini i respektueshëm

Ju punoni në një mjedis kompleks dhe sfidues. Çdo ditë ju hasni situata stresuese dhe njerëz që janë të frikësuar, të traumatizuar ose mosbesues ndaj autoriteteve, si dhe persona të tjerë që gënjejnë, mashtrojnë dhe shfaqin sjellje agresive.

Megjithatë, duke qenë shpesh pika e parë e kontaktit për shtetasit e vendeve të treta që arrijnë në BE, ju përfaqësoni si vendin tuaj ashtu dhe BE-në. Ju duhet të jeni profesionist, etik dhe të silleni në çdo kohë në një mënyrë që ju paraqet me dinjitet juve dhe autoritetin që përfaqësoni.

Mos harroni të jeni gjithmonë të respektueshëm. Të gjithë duhet të trajtohen me respekt. Respektoni gjithmonë dinjitetin njerëzor dhe jini të ndjeshëm ndaj diversitetit dhe dallimeve kulturore.

Jini të respektueshëm në mënyrë që të krijoni besim dhe të respektoheni. Mendojeni... Për ta fituar respektin, duhet të tregoni respekt fillimisht.. Mosrespektimi krijon tension që mund të kthehen në konflikt.

Mos diskriminoni

Askush nuk lejohet të diskriminojë një person tjetër. Sjellja diskriminuese, trajtimi i padrejtë ose praktikë e tjera diskriminuese bien ndesh me të drejtat themelore.

Për të shmangur diskriminimin dhe për të treguar ndjeshmëri, është e rëndësishme të komunikoni në një gjuhë që personi e kupton dhe në një mënyrë që e bën të ndihet i mbrojtur dhe i sigurt. Nëse është e nevojshme, përshtateni qasjen, gjuhën dhe komunikimin tuaj sipas gjinisë, moshës, gjendjes fizike dhe mendore dhe/ose nivelit arsimor të personit para jush.

Mos jini paragjykes

Mos paragjykoni të tjerët për veprimet, sjelljen dhe/ose pamjen e tyre të jashtme. Në vend që ta paragjykoni një person për çfarë ka bërë apo për pamjen e tij/saj, përpikuni ta njihni më shumë atë dhe të shkuarën e tij/saj. Një procedurë tjetër do të ndiqet në një vend tjetër, e kryer nga punonjës të tjerë që do të vlerësojnë nevojat për mbrojtje të personit dhe të drejtën për mbrojtje ndërkombëtare.

Mos e transmetoni paragjykimin me anë të komunikimit verbal dhe joverbal. Nëse e gjeni veten duke paragjykuar, ndaloni dhe kujtojeni vetes të vëzhgoni.

Jini dëgjues aktiv

Jini dëgjues i mirë. Dëgjimi aktiv është një nga komponentët kryesorë të aftësive të komunikimit. Kur jeni të vëmendshëm në dëgjim, jo vetëm që dëgjoni çfarë po thuhet, por shprehni një interes të sinqertë në të. Në këtë mënyrë ju tregoni respekt për personin me të cilin komunikoni, gjë që rrjedhimisht ndikon në cilësinë dhe sasinë e informacionit që do të mund të merrni.

- Dëgjoni me interes të sinqertë dhe me qëllimin për të kuptuar. Për të treguar dëgjim aktiv dhe mirëkuptim, ju mund të përdorni përmbledhje të shkurtra dhe të drejtpërdrejta, duke përsëritur pjesët kryesore të tregimit me fjalët e vetë aplikantit. Ju gjithashtu mund të përdorni deklaratë reflektuese për t'i siguruar personit që po e dëgjoni.
- Nxiteni personin të flasë. Përdorni shprehje inkurajuese si: "Më tregoni më shumë për këtë" ose "Çfarë ndodhi më pas?" Kjo e fton aplikantin të vazhdojë të flasë dhe të kontribuojë në mbajtjen dhe zgjerimin e tregimit.
- Bëni pyetje për të shprehur interes. Por mbani mend se informacioni më i saktë dhe më i dobishëm jepet në përgjigje të bisedave të lira. Nëse e ndërpritni personin shumë shpesh për të bërë pyetje shpesh, ju gjithashtu mund të zbehni motivimin ose besimin e personit dhe të zvogëloni gjasat për një rrëfim të plotë.
- Sigurohuni që personi që është para jush e kupton atë që keni thënë. Është përgjegjësi juaj që të kuptoheni nga të tjerët. Përdorni mundësinë për t'u qartësuar, për shembull duke i kërkuar personit të përsërisë me fjalët e veta pjesë të rëndësishme të informacionit që keni dhënë.

Përdorni një stil komunikimi të përshtatshëm dhe të ndjeshëm

Dallimet në gjuhë, kulturë dhe përvoja mund të krijojnë pengesa në komunikim. Shumë faktorë të tjerë, si mosha, gjinia, stresi, shëndeti fizik dhe mendor, si dhe rrethanat mjedisore mund të ndikojnë në aftësinë e personit për të shprehur veten. Nevoja për të komunikuar nëpërmjet përkthyesve gjithashtu rrit rrezikun e keqkuptimeve.

Prandaj është e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm për faktorët që mund të çrregullojnë procesin e komunikimit dhe të përshtatni përkatësisht stilin e komunikimit dhe gjuhën. Kjo do të ndihmojë për të zvogëluar ndjenjat e ankthit dhe stresit dhe për të siguruar cilësinë dhe sasinë e informacionit të marrë.

- Jini të ndjeshëm ndaj situatës personale, nëse e njihni, dhe përshtateni stilin tuaj të komunikimit në përputhje me të.
- Përdorni gjuhën e përshtatshme që personi mund ta kuptojë. Përpikuni gjithmonë të komunikoni sa më saktë, thjesht dhe qartë që të jetë e mundur.
- Jepni informacion personit rreth çfarë pritët nga ai / ajo, duke përfshirë detaje të vogla që shpesh i merrni për të mirëqena, të tilla si kush jeni, ku po shkoni, pse po e mbyllni derën e dhomës së intervistimit etj. si dhe rreth vetë procesit. Nuk duhet të supozoni se të gjithë i kuptojnë gjërat në të njëjtën mënyrë si ju.
- Garantoni besueshmëri. Shpjegoni se çdo gjë që thuhet do të mbetet konfidenciale, përveç nëse informacioni duhet të ndahet me organe të tjera qeveritare.
- Lëreni personin të flasë lirshëm. Nxiteni personin që të tregojë një ndodhi apo situatë me fjalët e tij / saj, me ritmin e tij / saj dhe pa ndërprerje.
- Bëni pyetje të përshtatshme në mënyrë të përshtatshme. Pyetjet e hapura tregojnë se po i kushtoni vëmendje personit. Filloni bisedën me pyetje të thjeshta.
- Jepuni të gjithëve mundësinë për të folur. Sigurohuni që askush të mos ndërhyjë dhe/ose të mos përgjigjet në emër të personit, përveç kur vepron në interesin e tij më të lartë.

Puna me përkthyesin

Legjislacioni i BE-së *për azilin* i detyron shtetet anëtare të bëjnë përgatitje për përkthim në masën e nevojshme për të lehtësuar aksesin në procedurën e azilit kur ka tregues se personat që mbahen në institucionet penitenciare ose që janë të pranishëm në pikat e kalimit kufitar mund të dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare. Shpesh ka nevojë për përkthyes për të kapërcyer hendekun gjuhësor midis personit dhe punonjësit në fjalë. Megjithatë, puna me përkthyesin kërkon që ju të përshtatni mënyrën e komunikimit me personin në fjalë dhe/ose të drejtimit të diskutimit. Këtu janë disa pika që duhet pasur parasysh kur përdorni shërbimet e një përkthyesi:

- Kushtojini vëmendje përzgjedhjes së përkthyesit. Nëse është e mundur, duhet alokuar një përkthyes i gjinisë së njëjtë nëse aplikanti e kërkon këtë;
- Informoni përkthyesin për përgjegjësinë dhe rolin e tij/saj gjatë intervistës;
- Verifikoni që personi në fjalë e kupton përkthyesin dhe *anasjelltas*;
- Drejtojuni direkt (në vetën e parë) personit në fjalë dhe jo përmes përkthyesit duke përdorur shprehje në vetën e tretë.
- Mundohuni të flisni ngadalë dhe qartë dhe ndaloni shpesh për t'i lejuar përkthimin në segmente të shkurtra, veçanërisht nëse jepen shpjegime të hollësishme, ose të ndërlikuara.

Këto parime janë edhe më të rëndësishme kur përdoren shërbimet e përkthyesit përmes telefonit.

Kushtojini vëmendje gjuhës tuaj të trupit

Gjuha e trupit është një lloj komunikimi joverbal, ku mendimet, qëllimet ose ndjenjat shprehen me anë të sjelljeve fizike, siç janë shprehjet e fytyrës, qëndrimi i trupit, gjestet, toni i zërit ose shfrytëzimi i hapësirës. Aftësia për të kuptuar dhe përdorur komunikimin joverbal është një mjet i fuqishëm komunikimi.

- Jini të vetëdijshëm për komunikimin tuaj joverbal. Gjuha juaj e trupit është një mjet i rëndësishëm për të krijuar besimin dhe për të krijuar e mbajtur raportin.
- Zgjidhni gjeeste të përshtatshme dhe qëndrime të përshtatshme të trupit. Përdorni gjuhë hapur trupi (shmangni kryqëzimin e krahëve; shmangni qëndrimin e mbyllur të trupit etj.). Përdorni ton të përshtatshëm zëri dhe shprehje të përshtatshme fytyre për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të hapur. Pasqyrimi i gjuhës së trupit të aplikantit ndonjëherë mund të krijojë atmosferë mirëkuptimi.
- Respektoni hapësirën personale dhe vendosni kontakt të përshtatshëm me sy. Nëse ndonjë aplikant nuk dëshiron të vendosë kontakt të drejtpërdrejtë me sy, respektojeni këtë fakt.
- Kini parasysh dallimet kulturore dhe gjinore në komunikimin joverbal. Kuptimi i gjuhës së trupit dhe i sinjaleve joverbale ndryshon nga kultura në kulturë dhe këto dallime mund të shkaktojnë keqkuptime. Mos bëni interpretim të nxituar të gjuhës së trupit të personit para jush.



Jini të vetëdijshëm për rrethanat tuaja personale

Çdo punonjës i kontaktit të parë duhet të kryejë detyrat e veta në rrethana kërkuese, shpesh duke takuar njerëz që vijnë nga kultura të ndryshme, me prejardhje të ndryshme sociale dhe përvoja të ndryshme jetësore. Ky mjedis pune interesant por jashtëzakonisht kërkues ndonjëherë mund të çojë në rutinë, stres, acarim ose madje edhe simptoma të traumave sekondare, të tilla si mendime penguese, lodhje kronike, trishtim, zemërim, përqendrim të dobët, shpërndarje, lodhje emocionale, frikë, turp, sëmundje fizike, hutim.

Jeta jonë private nganjëherë mund të jetë burim stresi dhe problemesh që mund të ndikojnë në qëndrimin tuaj ndaj detyrave profesionale dhe aftësinë për të përballuar stresin në punë.

Ju duhet të jeni të vetëdijshëm për këta faktorë dhe të bëni përpjekje të vazhdueshme për të minimizuar ndikimin e tyre. Nëse është e nevojshme, mos hezitoni të kërkon mbështetje nga kolegët ose mbikëqyrësit tuaj apo të kërkon këshillim profesional.

Treguesit që dikush mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare

Shumë persona që mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare nuk aplikojnë në mënyrë aktive për azil në vendin ku mbërrijnë. Shumë prej tyre mund të mos i njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre ose mund të zgjedhin të mos kërkojnë mbrojtje për shkak të situatës së tyre specifike ose për shkak të keqinformimit nga persona të tjerë, përfshirë kontrabandistët, për të drejtat dhe mundësitë e tyre. Nuk është realiste të presësh që ata të njohin procedurat e ndërlikuara të azilit dhe të Dublinit, të kenë besim të plotë se autoritetet do të trajtojnë drejtpërdrejt frikën e tyre në kufij apo në institucionet penitenciare, ose që të përdorin fjalët dhe shprehjet e duhura që mund t'u japin akses në procedurë.

Duke qenëpika e parë e kontaktit për personat në kufi, është detyra juaj të identifikoni kur një person po shpreh qëllimin për të aplikuar për mbrojtje, si dhe për t'i identifikuar e informuar në mënyrë proaktive kur ka tregues se ata mund të dëshirojnë të aplikojnë për azil.

Mos harroni se në shumicën e skenarëve njerëzit do të kenë mundësinë t'juaj shprehin juve për herë të parë nevojën e tyre për mbrojtje. Prandaj ju jeni hapi i parë kritik për të siguruar mbrojtje për personat në nevojë. Një identifikim i pasaktë në kufij dhe mospërcjellja e kërkesës për azil tek autoriteti kompetent mund të ketë pasoja serioze për personin në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Personi mund të kthehet në një vend ku i kërcënohet jeta ose liria ose ku ai përballlet me persekutim, vdekje, trajtim mizor, çnjerëzor e poshtërues ose me shkelje të tjera të rënda të të drejtave të njeriut.

Ky seksion ofron disa këshilla dhe udhëzime të dobishme për të ndihmuar punonjësit e kontaktit të parë në identifikimin e personave që mund të dëshirojnë të aplikojnë dhe për të siguruar që asnjë tregues i mundshëm të mos anashkalohet.

Kush mund të dëshirojë të bëjë aplikim?

→ **Kini parasysh se nuk duhet t'i mohoni askujt aksesin në procedurën e azilit.**

Të gjithë kanë të drejtën të kërkojnë azil.

→ **Kujtohuni gjithmonë se çdokush mund të jetë refugjat.**

Çdokush mund të ketë nevoja për mbrojtje, pavarësisht paraqitjes apo mënyrës së veprimit. Brenda flukseve të migrimit të përzier, personat me motive dhe objektiva të ndryshme udhëtojnë së bashku me njëri-tjetrin, shpesh duke përdorur të njëjtat rrugë dhe mjete transporti. Prandaj refugjatët dhe personat që udhëtojnë për arsye që nuk kanë të bëjnë me mbrojtjen mund të duken dhe të sillen në të njëjtën mënyrë.

Mos harroni se detyra juaj është të identifikoni personat që mund të dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare, t'u jepni informacione dhe t'i drejtoni tek autoriteti përkatës. Nuk është përgjegjësia juaj të vlerësoni nëse personi përpara jush ka nevoja për mbrojtje dhe nëse mund t'i jepet ose jo mbrojtje ndërkombëtare. Procedura të tjera do të pasojnë në një vend tjetër, të kryera nga punonjësit kompetentë, për të vlerësuar nevojat për mbrojtje të personit dhe për të përcaktuar nëse kualifikohet për mbrojtje ndërkombëtare.

→ **Po, çdokush mund të jetë refugjat pavarësisht vendit të origjinës, përkatësisë etnike dhe / ose pamjes së jashtme.**

Çdokush mund të jetë refugjat pavarësisht nëse

- **ka hyrë në shtetin anëtar ose është i pranishëm në territorin e tij në mënyrë të parregullt**, duke përdorur dokumente të rreme ose mashtruese ose pa asnjë dokumentacion, përfshirë edhe nëse i është ndaluar hyrja për shkak të situatës së kaluar të parregullt migratore;
- **është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore**. Viktima e trafikimit mund të ketë nevojë për mbrojtje, pa pasur të bëjë me çështjen e trafikimit. Ai / ajo gjithashtu mund të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare kur arratiset nga situata e trafikimit; ose vetë procedura e azilit mund të përdoret nga trafikantët si mjet për të lehtësuar hyrjen e personit në vendin pritës;
- **është fëmijë i pashoqëruar**. Legjislacioni i BE-së për azilin parashikon garanci specifike për të siguruar që fëmija i pashoqëruar të mund të përfitojë nga të drejtat dhe të përmbushë detyrimet e veta në kontekstin e azilit. Meqenëse fëmija është në thelb i cenueshëm, është shumë e rëndësishme që të jeni veçanërisht të ndjeshëm ndaj çdo treguesi shtesë të nevojave të veçanta dhe duhet të veproni gjithmonë në interesin më të lartë të fëmijës.

Personat me nevojë të shumëfishta për mbrojtje

Mos harroni, se përveç nevojës për mbrojtje ndërkombëtare, disa persona mund të kenë nevojë të tjera për mbrojtje që kërkojnë vëmendje urgjente. Për shembull, një person mund të jetë edhe viktimë e trafikimit edhe refugjat në të njëjtën kohë, ose edhe fëmijë i pashoqëruar edhe refugjat. Identifikimi i këtyre nevojave të shumëfishta dhe udhëzimi në procedurat e përshtatshme, veçanërisht në fazën menjëherë pas mbërritjes, mund të jenë shumë sfiduese.

Megjithatë, kategorizimi i grupeve të ndryshme të të ardhurve nuk duhet të zvogëlojë zhvillimin e masave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të gjithë personave pa dallim, përfshirë të drejtën për azil. Kështu, për shembull, në rastin e viktimave të trafikimit dhe fëmijëve të pashoqëruar, mekanizmat e duhur të mbrojtjes duhet të aktivizohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Megjithatë, duhet të garantohet edhe e drejta e tyre për azil si dhe në të njëjtën kohë të ndërmerren hapat e nevojshëm në kontekstin e azilit.

Lista joshteruese e treguesve

Kini parasysh se lista e treguesve e paraqitur më poshtë është vetëm treguese dhe, në asnjë rast, nuk përfshin të gjithë treguesit e mundshëm dhe ndryshimet e tyre. Në vend që të shihet si një formulë e saktë, ajo duhet të konsiderohet si udhëzues mbi faktorët tek të cilët duhet të fokusoheni gjatë vlerësimit të mundësisë që dikush mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Treguesit që një person mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare mund të shfaqen në mënyra të ndryshme. Ju mund t'i vëzhgoni, t'i mësoni nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me personin ose me persona të tjerë, t'i nxirrni nga dokumentet që paraqet personi dhe / ose t'i hasni në rrethana të tjera. Për t'i zbuluar më shpejt dhe më saktë treguesit, kushtojini vëmendje të veçantë elementeve në vijim:

Kush është personi dhe prej nga vjen

Vendi i origjinës

Njohuritë tuaja të përgjithshme për gjendjen aktuale të vendit të origjinës së personit, duke përfshirë rrethanat e përgjithshme politike, situatën e sigurisë si dhe respektimin e të drejtave themelore, janë një burim i rëndësishëm i treguesve për identifikimin e saktë të personave që mund të dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare. Për shembull, një vend i përfshirë në luftë (civile) apo konflikt të armatosur ose një vend i qeverisur nga një regjim diktatorial ka të ngjarë të jetë një vend burim i refugjatëve. Megjithatë, kini parasysh se asnjë vend nuk mund të konsiderohet përgjithësisht i sigurt për të gjithë qytetarët e tij, prandaj edhe ata që vijnë nga një vend i sigurt origjine mund të kenë nevojë individuale për mbrojtje.

Përkatësia etnike, feja, kombësia

Përveç kontekstit të përgjithshëm të vendit të origjinës, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nëse personi i përket pakicave (kombëtare, etnike dhe / ose fetare), duke qenë se ato shpesh kanë tendencë të jenë objekt i persekutimit apo dhunës. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që personat nga shumica mund të mos kenë nevojë për mbrojtje.

Rrethanat e përgjithshme të mbërritjes

Konteksti i mbërritjeve në shkallë të gjerë të grupeve të mëdha dhe individëve ose i një familjeje mund të krijojë pritshmëri të ndryshme në lidhje me profilin e njerëzve dhe nevojat e tyre për mbrojtje. Megjithatë, është e rëndësishme të kihet parasysh se refugjatët nuk e përdorin ekskluzivisht udhëtimin në një mënyrë apo tjetër.

Mosha

Fëmijët janë në thelb të cenueshëm dhe është shumë e rëndësishme që të jeni veçanërisht të ndjeshëm ndaj nevojave të tyre për mbrojtje, veçanërisht kur ata janë të pashoqëruar ose të ndarë. Çdo nëpunës që ka të bëjë me një fëmijë duhet të veprojë në interesin e tij/saj më të lartë, të jetë në gjendje të komunikojë me të në një mënyrë miqësore dhe të kuptueshme për fëmijët dhe të marrë parasysh nevojat e tjera të mundshme të veçanta të tij/saj.

Masat e posaçme mbrojtëse duhet të merren parasysh kur ka tregues për kontrabandimin e fëmijëve dhe / ose për trafikimin e fëmijëve. Për informacion të mëtejshëm, konsultohuni me *Frontex Vega Children Handbook*.⁽³⁾

Gjinia

Gratë dhe vajzat në kontekstin e migracionit mund ta gjejnë veten në një pozicion veçanërisht të cenueshëm për shkak të përvojës së tyre në vendin e origjinës, gjatë udhëtimit të tyre dhe për shkak të dallimeve sociale ose kulturore në vendin pritës. Prandaj, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së tyre të mundshme dhe / ose nevojave të tjera të veçanta. Kjo nuk do të thotë, natyrisht, se të gjitha gratë kanë të njëjtën shkallë cenueshmërie.

Duhet dhënë mbështetje e veçantë që gratë dhe vajzat të flasin me ju privatisht dhe që askush të mos ndërhyjë dhe/ose të mos u përgjigjet pyetjeve në emrin e tyre. Informacioni duhet gjithashtu t'u ofrohet drejtpërdrejt, në mënyrë që ato të mos privohen nga informacioni qenësor dhe aftësia për të marrë vendime të pavarura, duke përfshirë kërkimin e mbrojtjes ndërkombëtare ose ndihmës tjetër.

Nëse është e mundur, duhet të sigurohet prania e një punonjëseje të kontaktit të parë dhe një përkatëseje të gjinisë femërore. Gratë nuk duhet të detyrohen të flasin për incidente apo krime që lidhen me dhunën seksuale. Nëse është e përshtatshme, duke marrë parasysh moshën e tyre, gratë duhet të pyeten me ndjeshmëri nëse janë shtatzëna dhe, nëse është e nevojshme, të informohen për ndihmën në dispozicion.

⁽³⁾ http://frontex.europa.eu/assets/Publications/Training/VEGA_Children_Handbook.pdf

Statusi familjar

Është e rëndësishme të merret parasysh statusi familjar i personit. Disa kategori, të tilla si fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë, gratë beqare ose prindërit e vetëm me fëmijë, mund të jenë në një pozitë veçanërisht të cenueshëm dhe mund të kenë nevojë për mbrojtje si dhe për nevojë të tjera të veçanta.

Çfarë thotë personi

Deklaratat e personit janë çelësi dhe shpesh treguesi i vetëm nëse ai / ajo mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare ose mund të përbëjnë vetë aplikimin. Veçanërisht nëse personi shpreh, në ndonjë mënyrë, frikë ose shqetësim për persekutimi ose lëndim serioz nëse i refuzohet hyrja, duhet të merret si një tregues i tillë. Disa nga fjalët, shprehjet apo mesazhet kryesore që mund të sinjalizojnë se një person mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare përfshijnë:

- **Frika:** për shembull, nëse personi ka frikë të kthehet në vendin e tij / saj; ka frikë nga persekutimi; ka frikë se do të burgoset në vendin e tij / saj; ka frikë se do ta vrasin nëse kthehet në shtëpi.
- **Vdekja:** për shembull, nëse personi ka frikë se do ta vrasin pas kthimit.
- **Persekutimi:** për shembull, nëse personi thotë se ai / ajo ishte përndjekur në vendin e tij / saj ose ka frikë se do të persekutohet pas kthimit.
- **Tortura:** për shembull, nëse personat thonë se ai / ajo ose anëtarët e familjes së tij / saj janë torturuar ose nëse zbulon plagë ose lëndime të tjera që mund të jenë pasojë e torturës.
- **Lufta:** për shembull, nëse personi thotë se ka luftë (civile) ose po ndodh konflikt i armatosur në vendin e tij / saj; ai / ajo ka frikë se do të vritet në luftë etj.
- **Kthimi:** për shembull, nëse personi thotë se ai / ajo nuk mund të kthehet në vendin e tij / saj; ka frikë të kthehet; nuk ka ku të kthehet; ka frikë se do të persekutohet, do të burgoset, do të torturohet ose do ta vrasin nëse kthehet në shtëpi.
- **UNHCR (OKB) ose avokati:** për shembull, nëse personi kërkon zyrën e OKB-së ose UNHCR-së; dëshiron të takojë UNHCR-në; dëshiron të takojë një avokat etj.

Çfarë mund të vëzhgoni (pamja e jashtme dhe sjellja)



Mbani mend se deklaratat me gojë të aplikantit shumë shpesh bëhen në një gjuhë që nuk është gjuha e parë e aplikantit dhe / ose nëpërmjet një përkthyesi. Kjo pengesë gjuhësore mund të ketë ndikim në mirëkuptimin reciprok dhe të shkaktojë mospajtim ose mospërputhje të dukshme në deklaratat e personit.

Qasja / shmangia e oficerit

Pothuajse kudo në botë një oficer mund të identifikohet nëpërmjet uniformës së tij. Uniforma përcjell pushtet dhe autoritet dhe mund të ketë ndikim të fuqishëm psikologjik mbi personat që e shohin. Personat që mund të dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare kanë të ngjarë që t'i qasen një personi me uniformë dhe të krijojnë kontakt me të. Megjithatë, kini parasysh se njerëzit mund të vijnë edhe nga vende ku një uniforma ndjell mosbesim ose madje edhe frikë. Njerëzit shpesh iu shmangen personave me uniformë për shkak të frikës nga pasojat e hyrjes së paligjshme, mbajtjes së dokumenteve të falsifikuara ose të rreme ose mosmbajtjes së asnjë dokumenti. Në këto raste ju duhet të jeni në gjendje të interpretoni sinjale të tilla në mënyrë që të reagoni përshtatshëm ose të ofroni ndihmë.

Frika

Frika gjeneron nivele të larta stresi, i cili mund të shfaqet në shumë mënyra, si fizikisht ashtu edhe emocionalisht. Frika e fortë mund të bllokojë tërësisht një person dhe të shkaktojë pasivitet dhe apati. Nga ana tjetër, mund të shkaktojë hiperaktivitet, agresivitet dhe / ose sjellje të pazakontë. Kini parasysh se çdokush mund të ketë nevojë për mbrojtje, pavarësisht mënyrës së veprimit.

Vini re se frika dhe stresi mund ta bëjnë të vështirë për personin para jush t'i kuptojë pyetjet tuaja dhe jetë i fokusuar. Prandaj është e rëndësishme të krijohet një atmosferë sigurie dhe mbrojtjeje duke dhënë informacione dhe shpjegime.

Ndërveprimet mes njerëzve

Pothuajse të gjitha grupet bazohen në ndërvarësinë, qoftë grupi i madh apo i vogël, i strukturuar zyrtarisht ose lirshëm, i fokusuar në një aktivitet ose në një tjetër. Marrëdhëniet e natyrave të ndryshme mund të krijohen brenda një grupi, si marrëdhëniet pozitive të besimit dhe mbështetjes së ndërsjellë, ashtu edhe ato jo të shëndosha të bazuara në varësi, nënshtrim, kontroll dhe abuzim. Prandaj është shumë e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje ndërveprimit midis anëtarëve të një grupi dhe të kërkon shenja të dëmshme dhe problematike. Jepuni të gjithëve një mundësi për të folur me ju individualisht, përfshirë fëmijët dhe gratë. Sigurohuni që askush të mos ndërhyjë dhe/ose të mos u përgjigjet pyetjeve në emër të tyre, përveç kur veprojnë në interesin e tyre më të lartë.

Pamja e jashtme (lëndimet, shenjat, veshmbathjet, sendet personale etj.)

Plagët e dukshme, lëndimet ose shenjat e plagëve mund të jenë tregues i fortë i nevojave për mbrojtje. Shenjat e tjera të jashtme, të tilla si lloji dhe pamja e veshmbathjeve, përshtatshmëria e bagazheve dhe sendeve të tjera që personi mban me vete, mund të shprehin dëshirën për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare. Por kini parasysh se çdokush mund të ketë nevojë për mbrojtje, pavarësisht pamjes së jashtme.

Gjuha e trupit

Kushtojini vëmendje gjuhës së trupit të një personi, siç janë shprehjet e fytyrës, qëndrimi i trupit, gjestet, toni i zërit etj. Aftësia për të kuptuar dhe përdorur komunikimin joverbal është një mjet i fuqishëm komunikimi dhe mund të jetë tregues i rëndësishëm se një person mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare. Sidoqoftë, kini parasysh dallimet kulturore dhe gjinore në komunikimin joverbal. Kuptimi dhe përdorimi i gjuhës së trupit dhe i sinjaleve joverbale ndryshon nga kultura në kulturë dhe këto dallime mund të shkaktojnë keqkuptime. Prandaj, mos bëni interpretim të nxituar.



Mos harroni se gjykimi juaj në pikën e hyrjes ka rëndësi vendimtare dhe kritike. Konsultohuni me eprorin tuaj sa herë që keni ndonjë dyshim në lidhje me qëllimet e personit para jush. Një vendim i gabuar, p.sh. refuzimi i hyrjes, mund të ketë pasoja serioze për personin para jush. Prandaj, mendoni gjithmonë me kujdes para se të veproni.

Hapat e mëtejshëm

Jepni informacionin

Është detyra juaj të siguroheni që një person që mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare të jetë i informuar për mundësinë për ta bërë këtë dhe të këshillohet për mënyrën e veprimit. Në këtë mënyrë, aksesimi në procedurën e azilit mund të jetë efektive në praktikë.

Qëllimi kryesor i dhënies së informacionit është të sigurojë që personat që mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare të kenë akses efektive në procedurën e azilit dhe jenë në gjendje të marrin vendime të menduara mirë për të aplikuar ose jo për mbrojtje ndërkombëtare. Prandaj informacioni duhet të dhënë në kohën e duhur dhe duhet të jetë sa më i plotë që është e mundur, duke marrë parasysh rrethanat.

Informoni personin rreth mundësisë për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare. Është detyra juaj t'u jepni personave që mund të dëshirojnë të aplikojnë informacionet bazë për mbrojtjen ndërkombëtare dhe procedurën e azilit. Informacioni dhe niveli i detajeve të dhëna mund të ndryshojnë sipas rrethanave, por duhet të përfshijnë, së paku, këto informacione:

- të drejtat dhe detyrimet bazë të personit;
- çfarë është mbrojtja ndërkombëtare;
- kush konsiderohet si refugjat ose përfitues i mbrojtjes plotësuese;
- si mund të bëhet dhe dorëzohet aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare.

Sigurohuni që jeni i vetëdijshëm për informacionin që duhet dhënë në bazë të praktikës kombëtare dhe të keni në dispozicion informacionin e kontaktit të autoriteteve përgjegjëse, përfshirë shërbimet e specializuara për mbrojtjen e fëmijëve dhe palët e tjera të interesit, siç janë përkthyesit, OJQ-të, UNHCR-ja dhe çdo organizatë tjetër që ofron këshillim ligjor apo ndihmë tjetër. Sipas rastit, sigurohuni që të keni kopje shtesë të ndonjë fletëpalosjeje dhe broshure informuese në gjuhët përkatëse.

Është e nevojshme të komunikoni në një gjuhë që kuptohet nga personi që mund të kërkojë praninë e një përkthyesi. Komunikimi duhet të përshtatet me rrethanat dhe nevojat e veçanta të personit, duke përfshirë ndjeshmërinë ndaj gjinisë dhe / ose qasjen miqësore ndaj fëmijëve.

Njihni paraqitjen e një aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare



Kini parasysh se njerëzit mund ta shprehin synimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në mënyra të ndryshme. Çdo shprehje e frikës së persekutimit ose cenimit serioz nëse u refuzohet hyrja, e shprehur gojarisht ose me shkrim, konsiderohet si kërkesë e tillë. Nuk është e nevojshme të përdoret vetëm fjala "azil" apo "refugjat".

Sipas legjislacionit të BE-së për azilin, një person konsiderohet se bën aplikim për mbrojtje ndërkombëtare kur shpreh, në çfarëdo mënyre dhe forme, dëshirën për të aplikuar ose nëse mund të kuptohet se po kërkon mbrojtje ndërkombëtare.


Si punonjës i kontaktit të parë, shpesh ju do të jeni përfaqësuesi i parë i vendit tuaj me të cilin takohen shtetasit e vendeve të treta që vijnë në BE dhe tek i cili kanë mundësinë për të shprehur për herë të parë dëshirën e tyre për të aplikuar për azil.

Ju do të duhet të dalloni nëse një person ka shprehur dëshirën për të aplikuar, t'i jepni informacionin përkatës dhe ta drejtoni tek autoriteti kompetent për procedurën e azilit.

Mos harroni se detyra juaj është të identifikoni personat që kanë shprehur dëshirën për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare, t'u jepni informacione dhe t'i drejtoni tek autoriteti përkatës. **Nuk është përgjegjësia juaj të vlerësoni nëse personi përpara jush ka realisht nevojë për mbrojtje** dhe nëse duhet t'i jepet ose jo mbrojtje ndërkombëtare. Një procedurë tjetër do të pasojë diku tjetër, e kryer nga punonjës të tjerë, për të vlerësuar nevojat për mbrojtje të personit dhe të drejtën për mbrojtje ndërkombëtare.

Hapat e mëtejshëm nëse një person aplikon për mbrojtje ndërkombëtare

Kushdo që ka shprehur qëllimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare (d.m.th. që ka aplikuar) konsiderohet të jetë **aplikant për mbrojtje ndërkombëtare** me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë këtij statusi. Si punonjës i kontaktit të parë, ju jeni përgjegjës për të ndihmuar në garantimin e këtyre të drejtave, për shembull duke i drejtuar aplikantët tek autoritetet dhe organizatat përkatëse.



Regjistrojeni aplikimin, sipas rastit, ose drejtojeni aplikimin tek autoritetet kompetente për regjistrimin


Nëse një person ju shpreh dëshirën për të aplikuar për azil, ai / ajo ka "paraqitur" një aplikim dhe bëhet aplikant për mbrojtje ndërkombëtare. Pasi të jetë paraqitur aplikimi, ai duhet të regjistrohet nga autoriteti kompetent. Qëllimi i procesit të regjistrimit është që t'i bëjë më të efektshme të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga aplikimi. Prandaj, regjistrimi duhet të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni i BE-së.

Nëse i përkisni një autoriteti që është kompetent për regjistrimin e aplikimit, ju duhet ta kryeni regjistrimin brenda tri ditëve pune.

Nëse punoni për një autoritet që nuk është kompetent për regjistrimin, ju duhet ta drejtoni aplikimin tek autoriteti kompetent në mënyrë që të regjistrohet, jo më vonë se gjashtë ditë pune pas aplikimit. Rekomandohet që të mbani një regjistër me shkrim që keni marrë aplikimin, në përputhje me procedurat tuaja kombëtare.



Mos harroni se një aplikant për azil nuk duhet të ndëshkohet për shkak të hyrjes ose pranisë së tij të parregullt, me kusht që ai të paraqitet pa vonesë tek autoritetet.



Informojeni aplikantin për vendin dhe mënyrën e dorëzimit të aplikimit

Si oficer i autoritetit që ka të ngjarë të pranojë aplikime për mbrojtje ndërkombëtare, ju keni detyrë të informoni aplikantin për vendin dhe mënyrën e dorëzimit të aplikimit. Informacioni duhet dhënë për:

- çfarë është dorëzimi, përfshirë pasojat nëse aplikanti nuk e dorëzon aplikimin e tij / saj;
- cili autoritet është përgjegjës për procedurën e azilit;
- çfarë nevojitet për ta dorëzuar aplikimin;
- ku duhet të shkojë për ta dorëzuar aplikimin;
- si mund të arrijë atje.

Identifikoni nevojat e veçanta të aplikantit dhe drejtojeni te procedura e përshtatshme

Bëni këtë menjëherë. Për aplikantët me nevoja të shumëfishta, konsideroni se cilat mekanizma referimi duhet të aktivizohen dhe rendin e tyre, në mënyrë që të mund t'u përgjigjeni të gjitha nevojave të veçanta të aplikantit. Kështu, për shembull, në rastin e viktimave të trafikimit ose fëmijëve të pashoqëruar, mekanizmat e duhur të mbrojtjes mund të duhet të aktivizohen paralelisht me procedurën e azilit.

Hapat e mëtejshëm nëse një person që mund të ketë nevoja për mbrojtje nuk dëshiron të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare

Mund të hasni në situata ku një person që ka nevoja për mbrojtje vendos të mos aplikojë për azil. Është e drejta e tij / saj e zgjedhjes dhe askush nuk mund ta detyrojë që ta bëjë këtë. Megjithatë, mbanim mend se në raste të tilla ju ende duhet të përmbushni disa detyrime që ju takojnë sipas të drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit të BE-së, si:

Sigurimi i parimit të *moskthimit*

Askush nuk mund të kthehet në një vend ku rrezikohet nga torturimi, trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues ose ndëshkimi. Parimi i *moskthimit* vlen edhe për personat që janë në kufi ose në det të hapur. Ai përfshin kërkesën për t'i dhënë personit të drejtën për të hyrë në territor. Çdo kthim duhet të ndjekë procedurat e vendosura (ripranimin, procesin e kthimit etj.), përfshirë garancitë dhe masat e nevojshme ligjore. Dëbimet kolektive janë të ndaluara.

Informojeni personin rreth mundësisë për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare

Ju keni për detyrë të ofroni informacion bazë për mbrojtjen ndërkombëtare. Mos harroni se një nga qëllimet kyçe të dhënies së këtij informacioni është të sigurohet që personi në fjalë të jetë në gjendje të marrë vendime të mirëmenduara për të aplikuar ose jo.

Dhënia e informacionit mund të duhet të përshtatet me rrethanat dhe të përfshijë veçanërisht të drejtat që gëzojnë aplikantët (p.sh. të drejtën për të qëndruar) dhe detyrimet e azilkërkuesve sipas legjislacionit të BE-së dhe atij të brendshëm, si dhe pasojat e mosaplikimit për mbrojtje ndërkombëtare.

Konsideroni kontaktimin me UNHCR-në, OJQ-të dhe / ose organizata të tjera bazuar në legjislacionin dhe praktikën kombëtare, të cilat mund të ofrojnë këshillim dhe ndihmë më të specializuar.

Kur jeni në dyshim, konsultohuni me eprorin tuaj

Konsultohuni me eprorin tuaj sa herë që keni ndonjë dyshim në lidhje me qëllimet e personit para jush, veçanërisht nëse kthimi i tij / saj në vendin e origjinës apo transitit do të përbënte shkelje të mundshme të së drejtës ndërkombëtare.

Ndiqu procedurat tuaja kombëtare të veprimit për hapat e mëtejshëm

Akses në procedurën e azilit

- ▶ Çdo qenie njerëzore duhet të vlerësohet dhe respektohet.
- ▶ Kujdesi shëndetësor emergjent dhe nevojat bazë duhet të trajtohen së pari.

1

Çdokush mund të jetë refugjat

Çdokush mund të ketë nevoja për mbrojtje, pavarësisht nga vendi i origjinës, përkatësia etnike, pamja e jashtme apo sjellja.

2

Të gjithë kanë të drejtën e mbrojtjes kundër *kthimit*

Askush nuk mund të dëbohet ose të kthehet në një situatë ku ai / ajo do të përballej me rrezikun e persekutimit, dënimit me vdekje, torturës ose trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera çnjerëzore ose poshtëruese. Ky rregull vlen edhe për mospranimin në kufi dhe për çdo formë të largimit me forcë.

3

Personat e cenueshëm duhet të identifikohen dhe mbështeten në mënyrë të përshtatshme

Masat e marra në pikat e kalimit kufitar dhe në institucionet penitenciare janë vendimtare, ku mund të deklarohen ose zbulohen nevojat e veçanta të personave të cenueshëm, duke përfshirë fëmijët dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

4

Interesat më të lartë të fëmijës kanë përparësi në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët

Në vlerësimin e interesave më të lartë të fëmijës duhet të merren parasysh rast pas rasti faktorët si siguria dhe mbrojtja, mundësitë për ribashkim familjar, mirëqenia e fëmijës dhe pikëpamjet e fëmijës në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij.

5

Kushdo që mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare duhet të informohet për të drejtën e vet për ta bërë këtë

Informacionet mbi të drejtën për azil u duhet dhënë të gjithë personave që mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare për t'u siguruar që të kenë akses efektiv në procedurën e azilit.

6

Të gjithë kanë të drejtën të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare

Askujt nuk mund t'i mohohet akses në procedurën e azilit, edhe nëse ky person nuk i plotëson të gjitha kushtet e hyrjes.

7

Çdo shenjë ose shprehje e frikës në rast refuzimi të hyrjes mund të kuptohet si një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare

Njerëzit mund ta shprehin synimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në mënyra të ndryshme. Çdo shprehje e frikës së persekutimit ose cenimit serioz nëse u refuzohet hyrja - gojarisht ose me shkrim - konsiderohet si kërkesë e tillë. Nuk është e nevojshme të përdoret fjala "azil" ose "refugjat".

8

Aplikantët për mbrojtje ndërkombëtare nuk duhet të penalizohen për shkak të hyrjes ose pranisë së tyre të paligjshme

Personat që paraqiten pa vonesë tek autoritetet nuk duhet të penalizohen si rezultat i hyrjes ose pranisë së tyre të paligjshme.

9

Çdo aplikim duhet të regjistrohet ose të drejtohet për regjistrim tek autoriteti përgjegjës

Pasi të jetë paraqitur aplikimi, ai duhet të regjistrohet nga autoriteti përgjegjës. Regjistrimi duhet të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, brenda afateve të përcaktuara me ligj.

10

Parimi i *moskthimit* duhet të garantohet, edhe kur një person nuk aplikon për azil

Çdo kthim duhet të ndjekë procedurat e vendosura, duke përfshirë garancitë dhe masat e nevojshme ligjore. Askush nuk mund të kthehet në një vend ku rrezikohet nga tortura, trajtimi apo ndëshkimi çnjerëzor dhe poshtëruës, edhe nëse personi është në një situatë të parregullt migratore.

Shtojca — Referencat ligjore

Dinjiteti njerëzor

Legjislacioni i Bashkimit Evropian	
Karta e të Drejtave Themelore e BE-së	Neni 1 Dinjiteti njerëzor Dinjiteti njerëzor është i pacenueshëm. Ai duhet të respektohet dhe të mbrohet.

E drejta për të jetuar

Legjislacioni i Bashkimit Evropian	
Karta e të Drejtave Themelore e BE-së	Neni 2 E drejta për të jetuar 1. Të gjithë ka të drejtën për të jetuar. 2. Askush nuk do të dënohet me dënim me vdekje apo të ekzekutohet.

Ndalimi i torturës

E drejta ndërkombëtare	
Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut:	Neni 3 Ndalimi i torturës Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor ose poshtërues.
Legjislacioni i Bashkimit Evropian	
Karta e të Drejtave Themelore e BE-së	Neni 4 Ndalimi i torturës dhe trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor ose poshtërues Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor ose poshtërues.

Ndalimi i kthimit

E drejta ndërkombëtare

Konventa e Gjenevës:

Neni 33, paragrafi 1

Ndalimi i dëbimit ose kthimit

1. Asnjë shtet kontraktues nuk duhet të dëbojë ose të kthejë refugjatët në çfarëdo mënyre në kufijtë e territoreve ku jeta ose liria e tij do të kërcënohej për shkak të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose opinionit politik.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian

Karta e të Drejtave Themelore e BE-së

Neni 19(2)

Mbrojtja në rast të largimit, dëbimit ose ekstradimit

2. Askush nuk mund të largohet, të dëbohet ose të ekstradohet drejt një shteti ku ekziston një rrezik serioz që ai ose ajo t'i nënshtrohet dënimit me vdekje, torturës ose trajtimit apo ndëshkimit tjetër çnjerëzor ose poshtërues.

Kodi për Kufijtë e Shengenit

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për çdo person që kalon kufijtë e brendshëm ose të jashtëm të shteteve anëtare, pa cenuar:

[...]

b) të drejtat e refugjatëve dhe personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, veçanërisht në lidhje me parimin e *moskthimit*.

Neni 3, germa "a"

Të drejtat themelore

Gjatë zbatimit të kësaj rregulloreje, shtetet anëtare duhet të veprojnë në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, duke përfshirë Kartën e të Drejtave Themelore; të drejtën ndërkombëtare përkatëse, përfshirë Konventën e Gjenevës; detyrimet që kanë të bëjnë me aksesin në mbrojtjen ndërkombëtare, në veçanti parimin e *moskthimit*; dhe të drejtat themelore. [...]

Neni 13, paragrafi 1

Refuzimi i hyrjes

1. Një shtetasi të një vendi të tretë që nuk i plotëson të gjitha kushtet e hyrjes të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, dhe nuk i përket kategorive të personave të përmendur në nenin 5, paragrafi 4, i refuzohet hyrja në territoret e shteteve anëtare. Kjo nuk duhet të cenojë zbatimin e dispozitave të veçanta në lidhje me të drejtën për azil dhe për mbrojtje ndërkombëtare ose lëshimin e vizave për qëndrim afatgjatë.

Rregullorja 656/2014

Lidhur me mbikëqyrjen e kufirit të jashtëm detar në kontekstin e operacioneve të "Frontex"

Neni 4, paragrafi 1

Mbrojtja e të drejtave themelore dhe parimi i moskthimit

1. Asnjë person, në kundërshtim me parimin e *moskthimit*, nuk duhet të zbarkohet, të detyrohet të hyjë, të udhëhiqet ose t'i dorëzohet autoriteteve të një vendi, ku ndër të tjera, ekziston një rrezik serioz që ai ose ajo t'i nënshtrohet dënimit me vdekje, torturës, persekutimit ose trajtimit apo ndëshkimit tjetër çnjerëzor ose poshtërues, ose kur jeta dhe liria e tij / saj do të kërcënoheshin për shkak të racës, fesë, kombësisë, orientimit seksual, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo opinionit të tij politik, ose nga të cilat ekziston një rrezik serioz për dëbim, largim ose ekstradim në një vend tjetër në kundërshtim me parimin e *moskthimit*.

Direktiva për kthimin 2008/115/KE	Neni 4, paragrafi 4 Në lidhje me shtetasit e vendeve të treta, të cilët përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive në përputhje me nenin 2, paragrafi 2, germa "a", shtetet anëtare duhet [...]: (b) të respektojnë parimin e moskthimit. Neni 5 Gjatë zbatimit të kësaj direktive, shtetet anëtare duhet të [...] dhe të respektojnë parimin e moskthimit.
Rregullorja VIS (KE) nr. 767/2008	Neni 31, paragrafi 3 Transferimi i të dhënave drejt vendeve të treta Transferimet e tilla të të dhënave personale drejt vendeve të treta ose organizatave ndërkombëtare nuk duhet të cenojnë të drejtat e refugjatëve dhe personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, veçanërisht në lidhje me moskthimin.
Rregullorja Eurosur e BE-së, (BE) nr. 1052/2013	Neni 2, paragrafi 4 Gjatë zbatimit të kësaj rregulloreje, shtetet anëtare dhe Agjencia duhet të respektojnë të drejtat themelore, në veçanti parimet e moskthimit dhe të respektojnë dinjitetin njerëzor dhe kërkesat për mbrojtjen e të dhënave.

E drejta për azil

Legjislacioni i Bashkimit Evropian

Karta e të Drejtave Themelore e BE-së	Neni 18 E drejta për azil E drejta për azil duhet të garantohet duke respektuar rregullat e Konventës së Gjenevës të 28 korrikut 1951 dhe të Protokollit të 31 janarit 1967 në lidhje me statusin e refugjatëve dhe në përputhje me Traktatin themelues të Komunitetit Evropian.
Rishikimi i DPA-së	Neni 7, paragrafi 1 Aplikimet e bëra në emër të të varurve ose të të miturve 1. Shtetet anëtare duhet të sigurohen që çdo i rritur me zotësi juridike ka të drejtën të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare në emër të tij / saj. 2. Shtetet anëtare mund të parashikojnë që një aplikim mund të bëhet nga një aplikant në emër të personave të varur prej tij. Në raste të tilla, shtetet anëtare duhet të sigurohen që të rriturit e varur të miratojnë paraqitjen e aplikimit në emër të tyre, dhe në rast të kundërt do të kenë mundësi të aplikojnë për llogari të vet. [...] 3. Shtetet anëtare duhet të sigurohen që një i mitur ka të drejtën të bëjë aplikim për mbrojtje ndërkombëtare ose në emër të vet, nëse ai / ajo ka zotësinë juridike të veprojë në procedurat sipas legjislacionit të shtetit anëtar në fjalë, ose nëpërmjet prindërve të tij / të saj ose anëtarëve të tjerë të rritur të familjes, ose nëpërmjet një të rrituri përgjegjës për të, qoftë sipas ligjit ose praktikës së shtetit anëtar në fjalë, ose përmes një përfaqësuesi.

Mosdiskriminimi

E drejta ndërkombëtare

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut:	Neni 14 Ndalimi i diskriminimit Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë do të sigurohet pa diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, opinionit politik apo tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, lidhjes me një pakicë kombëtare, pronësisë, prejardhje, lindjes apo ndonjë statusi tjetër.
Konventa e Gjenevës:	Neni 3 Mosdiskriminimi Shtetet kontraktuese duhet të zbatojnë dispozitat e kësaj Konvente për refugjatët pa diskriminim për shkak të racës, fesë ose vendit të origjinës.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian

Karta e të Drejtave Themelore e BE-së	Neni 21, paragrafi 1 Mosdiskriminimi Ndalohet çdo diskriminim mbi çfarëdolloj baze si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose sociale, karakteristikat gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionit politik apo ndonjë opinion tjetër, anëtarësia në një pakicë kombëtare, pronësia, lindja, aftësia e kufizuar, mosha ose orientimi seksual.
--	--

Mosndëshkimi

E drejta ndërkombëtare

Konventa e Gjenevës:	Neni 31, paragrafi 1 Refugjatët që gjenden në mënyrë të paligjshme në vendin e refugjatëve 1. Shtetet kontraktuese nuk duhet t'u vendosin refugjatëve penaltete për shkak të hyrjes apo pranisë së paligjshme të tyre, të cilët vijnë direkt nga një territor ku jeta ose liria e tyre është kërcënuar në kuptim të nenit 1, hyjnë ose janë të pranishëm në territorin e tyre pa autorizim, me kusht që ata të paraqiten pa vonesë tek autoritetet dhe të tregojnë shkakun e arsyeshëm për hyrjen ose praninë e tyre të paligjshme.
-----------------------------	--

Legjislacioni i Bashkimit Evropian

Kodi për Kufijtë e Shengenit	Neni 13, paragrafi 1 Refuzimi i hyrjes Një shtetasi të një vendi të tretë që nuk i plotëson të gjitha kushtet e hyrjes të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, dhe nuk i përket kategorive të personave të përmendur në nenin 5, paragrafi 4, i refuzohet hyrja në territoret e shteteve anëtare. Kjo nuk duhet të cenojë zbatimin e dispozitave të veçanta në lidhje me të drejtën për azil dhe për mbrojtje ndërkombëtare ose lëshimin e vizave për qëndrim afatgjatë.
-------------------------------------	---

Akresi në procedurën e azilit

Legjislacioni i Bashkimit Evropian	
Rishikimi i DPA-së⁽¹⁾	Pika 25 Në interesat të njohjes së drejtë të atyre personave që kanë nevojë për mbrojtje si refugjatë në kuptim të nenit 1 të Konventës së Gjenevës ose si persona që kualifikohen për mbrojtje plotësuese, çdo aplikant duhet të ketë akses efektiv në procedura, [...] Pika 26 Me qëllim sigurimin e aksesit efektiv në procedurën e ekzaminimit, punonjësit që kanë kontaktin e parë me personat që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, në veçanti punonjësit që kryejnë mbikëqyrjen e kufijve tokësorë ose detarë ose që kryejnë kontrollet kufitare, duhet të marrin informacionin përkatës dhe trajnimin e nevojshëm mbi mënyrat e njohjes dhe trajtimit të aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare, ndër të tjera, duke marrë parasysh edhe udhëzimet përkatëse të hartuara nga EASO. Ata duhet të jenë në gjendje që shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi që janë të pranishëm në territor, duke përfshirë edhe në kufi, në ujërat territoriale ose në zonat tranzit të shteteve anëtare dhe që bëjnë aplikim për mbrojtje ndërkombëtare, t'u japin informacione për vendin dhe mënyrën e dorëzimit të aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare. Kur këta persona janë të pranishëm në ujërat territoriale të një shteti anëtar, ata duhet të zbarkohen në tokë dhe aplikimet e tyre duhet të shqyrtohen në përputhje me këtë direktivë. Pika 28 Me qëllim që të lehtësohet akresi në procedurën e ekzaminimit në pikat e kalimit kufitar dhe në institucionet penitenciare, duhet të vihen në dispozicion informacioni për mundësinë e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare. Komunikimi bazë i nevojshëm për t'u mundësuar autoriteteve kompetente të kuptojnë nëse personat shprehin dëshirën e tyre për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare duhet të sigurohet nëpërmjet përkthimit. Neni 8, paragrafi 1 Informimi dhe këshillimi në institucionet penitenciare dhe në pikat e kalimit kufitar Aty ku ka tregues se shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi që mbahen në institucionet penitenciare ose që gjenden në pikat e kalimit kufitar, duke përfshirë zonat e transitit, në kufijtë e jashtëm, mund të dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare, shtetet anëtare duhet t'u japin informacione mbi mundësinë për ta bërë këtë. Në këto institucione penitenciare dhe pika kalimi, shtetet anëtare duhet të marrin masa për përkthimin deri në masën e nevojshme për të lehtësuar aksesin në procedurën e azilit.
Kodi për Kufijtë e Shengenit	Neni 3, germa "a" Të drejtat themelore Gjatë zbatimit të kësaj rregulloreje, shtetet anëtare duhet të veprojnë në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, duke përfshirë Kartën e të Drejtave Themelore; të drejtën ndërkombëtare përkatëse, përfshirë Konventën e Gjenevës; detyrimet që kanë të bëjnë me aksesin në mbrojtjen ndërkombëtare, në veçanti parimin e <i>moskthimit</i>; dhe të drejtat themelore. [...]

Paraqitja dhe regjistrimi i aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare

Legjislacioni i Bashkimit Evropian

Rishikimi i DPA-së

Pika 27

Duke pasur parasysh se shtetasit e vendeve të treta dhe personat pa shtetësi që kanë shprehur dëshirën e tyre për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare janë aplikantë për mbrojtje ndërkombëtare, ata duhet të përmbushin detyrimet dhe të përfitojnë nga të drejtat, sipas kësaj direktive dhe Direktivës 2013/33/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 26 qershorit 2013 që përcakton standardet për pritjen e aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare. Për këtë qëllim, shtetet anëtare duhet ta regjistrojnë faktin se këta persona janë aplikantë për mbrojtje ndërkombëtare sa më shpejt që të jetë e mundur.

Neni 2, germa "c"

Përkufizimet

"Aplikant" është një shtetas i një vendi të tretë ose një person pa shtetësi, i cili ka bërë aplikim për mbrojtje ndërkombëtare në lidhje me të cilën nuk është marrë ende një vendim përfundimtar.

Neni 6

Akresi në procedurë

1. Kur një person bën një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare pranë një autoriteti kompetent sipas legjislacionit të brendshëm për regjistrimin e aplikimeve të tilla, regjistrimi duhet të bëhet jo më vonë se tri ditë pune pas paraqitjes së aplikimit.

Nëse aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare bëhet pranë autoriteteve të tjera, të cilat kanë të ngjarë të marrin aplikime të tilla, por nuk janë kompetente për regjistrimin sipas legjislacionit të brendshëm, shtetet anëtare duhet të sigurohen që regjistrimi të bëhet jo më vonë se gjashtë ditë pune pas aplikimit.

[...]

5. Kur aplikimet e njëkohshme për mbrojtje ndërkombëtare nga një numër i madh shtetasish të vendeve të treta ose personash pa shtetësi e bëjnë shumë të vështirë respektimin në praktikë të afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 1, shtetet anëtare mund të parashikojnë që afati të zgjatet deri në 10 ditë pune.

Personat e cënueshëm

Legjislacioni i Bashkimit Evropian

Rishikimi i DPA-së

Pika 29

Disa aplikantë mund të kenë nevojë për garanci të veçanta procedurale, për shkak të, ndër të tjera, moshës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, sëmundjes së rëndë, çrregullimeve mendore ose si pasojë e torturës, përdhunimit ose formave të tjera të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale. Shtetet anëtare duhet të përpiqen të identifikojnë aplikantët që kanë nevojë për garanci të veçanta procedurale para se të merret vendimi i shkallës së parë. Aplikantëve duhet t'u sigurohet mbështetje e përshtatshme, duke përfshirë kohën e mjaftueshme, me qëllim krijimin e kushteve të nevojshme për akses efektiv në procedura dhe për paraqitjen e elementeve të nevojshme për të mbështetur aplikimin e tyre për mbrojtje ndërkombëtare.

Neni 24

Aplikantët që kanë nevojë për garanci të veçanta procedurale

1. Shtetet anëtare do të vlerësojnë, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, pasi të është paraqitur një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare, nëse aplikanti ka nevojë për garanci të veçanta procedurale.

2. Vlerësimi i përmendur në paragrafin 1 mund të integrohet në procedurat kombëtare ekzistuese dhe / ose në vlerësimin e përmendur në nenin 22 të Direktivës 2013/33/BE dhe nuk duhet të marrë formën e një procedure administrative.

3. Shtetet anëtare duhet të sigurohen që, në rastin kur aplikantët identifikohen si aplikantë në nevojë për garanci të veçanta procedurale, atyre t'u sigurohet mbështetje e përshtatshme me qëllim që t'u mundësohet të përfitojnë nga të drejtat dhe të përmbushin detyrimet e kësaj direktive gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurës së azilit.

Kur një mbështetje e tillë e përshtatshme nuk mund të sigurohet në kuadrin e procedurave të përmendura në nenin 31, paragrafi 8, dhe nenin 43, veçanërisht kur shtetet anëtare konsiderojnë se aplikanti ka nevojë për garanci të veçanta procedurale si rezultat i torturës, përdhunimit ose formave të tjera të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale, shtetet anëtare nuk duhet të zbatojnë, ose do të pushojnë së zbatuari nenin 31, paragrafi 8, dhe nenin 43. Kur shtetet anëtare zbatojnë nenin 46, paragrafi 6, për aplikantët për të cilët nuk mund të zbatohet neni 31, paragrafi 8, dhe neni 43 në pajtim me këtë nënparagraf, shtetet anëtare duhet të sigurojnë së paku garancitë e parashikuara në nenin 46, paragrafi 7.

4. Shtetet anëtare duhet të sigurohen që nevoja për garanci të veçanta procedurale të trajtohet gjithashtu në përputhje me këtë direktivë, kur një nevojë e tillë bëhet e dukshme në një fazë të mëvonshme të procedurës, pa pasur nevojë për të rifilluar procedurën domosdoshmërisht.

Rishikimi i DP-së ⁽²⁾	Neni 21 Dispozitat për personat e cenueshëm Parimi i përgjithshëm Shtetet anëtare duhet të marrin parasysh situatën specifike të personave të cenueshëm si të miturit, të miturit e pashoqëruar, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, gratë shtatzëna, prindërit e vetëm me fëmijë, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, personat me sëmundje të rënda, personat me çrregullime mendore dhe persona të cilët i janë nënshtruar torturës, përdhunimit ose formave të tjera të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale, siç janë viktimat e gjymtimit të organeve gjenitale të femrave, në legjislacionin e brendshëm që vë në zbatim këtë direktivë.
Rregullorja 656/2014 Lidhur me mbikëqyrjen e kufirit të jashtëm detar në kontekstin e operacioneve të "Frontex"	Neni 4, paragrafi 4 Gjatë një operacioni detar, njësitë pjesëmarrëse duhet të trajtojnë nevojat e veçanta të fëmijëve, duke përfshirë të miturit e pashoqëruar, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, personat që kanë nevojë për ndihmë urgjente mjekësore, personat me aftësi të kufizuara, personat që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe persona të tjerë që gjenden në një situatë veçanërisht të cenueshëm.

(¹) Direktiva 2013/32/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2013 për procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare (e rishikuar), më tutje referuar si DPA-ja e rishikuar.

(²) Direktiva 2013/33/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2013 që përcakton standardet për pritjen e aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare (e rishikuar).

HOW TO OBTAIN EU PUBLICATIONS

Free publications:

- one copy: via EU Bookshop (<http://bookshop.europa.eu>);
- more than one copy or posters/maps: from the European Union's representations (http://ec.europa.eu/represent_en.htm); from the delegations in non-EU countries (http://eeas.europa.eu/delegations/index_en.htm); by contacting the Europe Direct service (http://europa.eu/europedirect/index_en.htm) or calling 00 800 6 7 8 9 10 11 (freephone number from anywhere in the EU) (*).

(*) The information given is free, as are most calls (though some operators, phone boxes or hotels may charge you).

Priced publications:

- via EU Bookshop (<http://bookshop.europa.eu>).

Priced subscriptions:

- via one of the sales agents of the Publications Office of the European Union (http://publications.europa.eu/others/agents/index_en.htm).



■ Publications Office
of the European Union